

R A P O R T

Monitorimi i shpenzimeve të buxheteve dhe partive politike në procesin parazgjedhor dhe zgjedhor

Shkurtesat

VMRO-DPMNE – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas
TVSH – Tatimi i Vlerës së Shtuar
EShR – Enti Shtetëror i Revizionit
KShPK – Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
PDSH – Partia Demokratike Shqiptare
BDI – Bashkimi Demokratik për Integrim
NJVL – Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
NP – Ndërmarrje Publike
QAE – Qendra për Analiza Ekonomike
PPD – Partia për Prosperitet Demokratik
MKD – Denari Maqedonas
RM – Republika e Maqedonisë
LSDM – Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë
TI-M – Transparenci Interneshënëll – Maqedoni
DAP – Drejtoria e të Ardhurave Publike

HYRJE.....	4
Zgjedhjet parlamentare 2016	5
I. SHPENZIME TË PARTIVE POLITIKE GJATË KOHËS SË FUSHATËS ZGJEDHORE	6
Zbulime kyçe	7
1. Kategorizimi i shpenzimeve të partive politike.....	9
Shpenzime në nivelin kombëtar	10
Shpenzime në nivel lokal.....	11
Shpenzimet për pjesën kreative dhe provizionet e agjencive	11
2. Vlerësim i shpenzimeve për përfaqësim mediatik.....	12
3. Vlerësimi i shpenzimeve të partive politike në fushatën zgjedhore.....	13
Koalicioni VMRO DPMNE.....	15
Koalicioni LSDM.....	16
Bashkimi demokratik për integrim (BDI)	17
Partia demokratike e shqiptarëve (PDSH)	18
Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi – Bloku i tret	19
Partia për prosperitet demokratik (PDP).....	20
Koalicioni – Aleanca e shqiptarëve	21
Partia liberale e Maqedonisë (LP).....	22
Koalicion VMRO për Maqedoninë	23
Lëvizja BESA	24
E majta.....	25
4. Rekomandime.....	26
II. MONITORIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE NË PERIUdhËN PARAZGJEDHJEVE DHE PERIUdhËN E ZGJEDHJEVE	27
1. Monitorim i shpenzimeve buxhetore në nivel qendror	29
Zbulimet kyçe	30
2. Monitorim i shpenzimeve në nivel të pushtetit lokal	34
Zbulim kyçe.....	35

HYRJE

Transparensi Interneshënëll – Maqedoni (TI-M) bashkë me Qendrën për Analiza Ekonomike (QAE) zbaton projektin *“Monitorimi i shpenzimeve të buxheteve dhe partive politike në procesin parazgjedhor dhe zgjedhor”* financiarisht i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës. Projekti ka pasur për qëllim ndjek aktivitetet në lidhje me zgjedhjet e 24 prillit 2016, të cilat më vonë ishin shtyrë dhe të caktuar sërish për 5 qershor 2016. Për shkak të situatës politike në Republikën e Maqedonisë, zgjedhjet e caktuar për 5 qershor, gjithashtu ishin shtyrë për kohë të pacaktuar që në fund të mbahen më 11 dhjetor 2016.

Për të siguruar mbulim përkatës të gjithë territorit të vendit, si dhe për shkak të vëllimit të madh të të dhënave që janë mbledhur dhe analizuar, ishte e nevojshme që të angazhohen 8 organizata joqeveritare lokale, me përvojë në monitorimin e proceseve, që kanë pasur për detyrë të zbatojnë monitorim në 24 komnatat në nivel të Republikës së Maqedonisë.¹

Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare që janë zhvilluar më 11 dhjetor 2016 kanë marrë pjesë 6 parti politike dhe 5 koalicione me 58 lista të kandidatëve në 7 njësi zgjedhore të territorit të Republikës së Maqedonisë (RM), dhe në listën gjenden: Koalicioni VMRO-DPMNE, Koalicioni VMRO për Maqedoninë, Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi – Blloku i Tretë, Koalicioni LSDM, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), Lëvizja BESA, Partia për Prosperitet Demokratik (PDP), Aleanca e Shqiptarëve, Partia Liberale (PL) dhe E Majta.

¹ Bëhet fjalë për organizatat në vijim: ZIP Instituti – Shkup (për komnatat: Aerodrom, Gazi Babë, Qendër), Fokus - Veles (për komnatat: Veles, Kavadar, Çashka), DROM - Kumanovë (për komnatat: Kumanovë, Kriva Pallankë, Kratovë), Eho – Shtip (për komnatat: Shtip, Koçani, Karbinci), LAR Strugë (për komnatat: Strugë, Ohër, Makedonski Brod).

Zgjedhjet parlamentare 2016

Në përputhje me Kodin Zgjedhor (neni 4, paragrafi 2) në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë zgjidhet 123 deputetë, prej të cilëve 120 zgjidhen sipas modelit proporcional, dhe territori i Republikës së Maqedonisë është ndarë në gjashtë njësi zgjedhore, në të cilat zgjedhën 20 deputetë dhe tre deputetë zgjidhen sipas modelit proporcional në një njësi zgjedhore që i përfshin Evropën, Afrikën, Amerikën Veriore dhe Jugore, Australinë dhe Azinë. Në bazë të listave të përcaktuara të kandidatëve për deputetë në njësitë zgjedhore 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 janë propozuar dhe konfirmuar 58 lista me gjithsej 1.160 kandidatë për zgjedhje të deputetëve, ndërsa në njësinë zgjedhore 7 janë propozuar dhe konfirmuar 4 lista me gjithsej 12 kandidatë për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Zyrtarisht fushata zgjedhore ka filluar më 21 nëntor 2016 dhe ka përfunduar 24 orë para zhvillimit të zgjedhjeve. Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ) në raportin e publikuar më 28.12.2016 ka konstatuar që numri i plotë i votuesve ka qenë **1.784.416, në zgjedhjet e zhvilluara më 11 dhjetor 2016 kanë votuar gjithsej 1.191.852 votues, gjegjësisht jehona ka qenë 66,79 %.**

Sipas rezultateve të fundit nga Zgjedhjet e Parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, KShZ-ja në seancë të zhvilluar më 28.12.2016 ka konfirmuar listat vijuese të fundit:

1. Koalicioni VMRO-DPMNE – 51- vende deputetësh
2. Partia Demokratike Shqiptare PDSH – 2 vende deputetësh
3. Bashkimi Demokratik për Integrim BDI - 10 vende deputetësh
4. Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë LSDM – 49 vende deputetësh
5. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët – 3 vende deputetësh
6. Lëvizja BESA – 5 vende deputetësh

Në bazë të rezultateve të përcaktuara nga KShZ-ja, nga njësia zgjedhore 7 nuk janë zgjedhur deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, sepse asnjë prej listave të deputetëve nuk ka marrë numrin e mjaftueshëm të votave, në përputhje me nenin 4, paragrafin 6 të Kodit Zgjedhor.

I. SHPENZIME TË PARTIVE POLITIKE GJATË KOHËS SË FUSHATËS ZGJEDHORE

Në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Maqedonisë, neni 85, partitë politike dhe koalicionet, si pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, kanë për obligim të paraqesin gjithsej tre raporte në ditën e 11-të të fushatës zgjedhore, një dite pa përfundimit të fushatës zgjedhore dhe raportin e plotë financiare për fushatën zgjedhore. Këto raporte financiare për fushatën zgjedhore parashtrohen tek KShZ, EShR dhe KShPK dhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Në zgjedhjet e zhvilluara më 11 dhjetor 2015, të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhjet me kohë kanë dorëzuar raportet e tyre financiare, ndërsa TI-M më 12 dhjetor 2016 ka zhvilluar një konferencë për shtyp në të cilën janë prezantuar zbulimet fillestare.

TI-M ka përpiluar një metodologji të posaçme, me anë të cilës do të bëjë monitorim të shpenzimeve të partive politike në marketingun politik në nivel lokal dhe kombëtar. Me metodologjinë që përbëhet nga monitorimi i aktiviteteve të pjesëmarrësve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, janë mbledhur të dhënat për aktivitetet e vërteta në fushatat zgjedhore në teren dhe në bazë të kësaj ka bërë vlerësim të shpenzimeve të vërteta në kuadër të fushatës zgjedhore. Gjatë përpilimit të metodologjisë janë marrë parasysht: numri i banorëve në vendbanimin, sipërfaqja që përfshin vendbanimin, numri i vendeve zgjedhore dhe numri i votuesve të regjistruar në listën zgjedhore.

Metodologjia është përbërë nga dy pjesë:

1. Monitorim i shpenzimeve për aktivitete marketingu të partive politike në procesin parazgjedhor dhe zgjedhor në nivelin kombëtar;
2. Monitorim i shpenzimeve për aktivitete marketingu të partive politike në procesin parazgjedhor dhe zgjedhor në nivelin lokal.

Për nevojat e metodologjisë së zhvilluar janë krijuar më tepër vegla (dokumenteve, baza më të dhëna, Excel vegla), pyetësor dhe formularë për monitorim në nivelin kombëtar dhe lokal, të cilat do të mundësojnë një platformë për ndjekjen e shpenzimeve për aktiviteteve marketingu të partive politike.

Zbulime kyçe

Të gjitha partitë politike dhe koalicione që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë të zhvilluar më 11 dhjetor 2016, me kohë kanë dorëzuar raportet financiare për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë kohës së fushatës zgjedhore.

TI-M në përputhje me analizën e bërë të shpenzimeve të vlerësuara për fushatën zgjedhore ka arritur të përcaktojë zbulimet vijuese kyçe:


1. **Partitë kanë shpenzuar më tepër sesa kanë paraqitur** – 10 parti politike dhe koalicione (Koalicioni VMRO-DPMNE, Koalicioni LSDM, BDI, PDSH, PDP, Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi, Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët”, Partia Liberale, BESA, e Majta) **kanë harxhuar shumëfish më tepër** mjete financiare gjatë kohës së fushatës zgjedhore, nga ajo që kanë prezantuar në raportet e tyre financiare.
2. **Një parti ka paraqitur më tepër nga që ka shpenzuar** – Koalicioni VMRO për Maqedoninë ka **publikuar më tepër** nga ajo që ka shpenzuar sipas analizës sonë;
3. **Fushatat zhvillohet në nivel kombëtar** – Tre partitë më të mëdha politike dhe koalicionet VMRO-DPMNE, LSDM dhe BDI, dhe partia e re e formuar Lëvizja Besa kanë ndarë më tepër mjete për fushatën zgjedhore në **nivel kombëtar** në të cilën bëjnë pjesë shpenzimet vijuese: prezantim mediatik në televizione kombëtare, reklamim të jashtëm, medie të shtypur, internet portale, mitingje, material promovuese, pjesë kreative (përpilim i videove, post produksion, audio produksion, zgjedhje grafike artistike, përgatitje për shtypje, përgatitje të banderolave) dhe provizione për agjenci;
4. **Çmimi për një votë të fituar më e madhe nga ajo e parashikuar me ligj – çmimi për votë të fituar** është rreth 55 denarë (E majta) deri më 704 denarë (Partia Liberale), ose **mesatarisht 347 denarë**. Sipas shpenzimeve të vlerësuar dhe publikuar dallimi më i vogël për votë të fituar është 20 denarë (e vërejtur tek Koalicioni VMRO-DPMNE dhe Koalicioni VMRO për Maqedoninë. Në përputhje me Kodin Zgjedhor të drejtë kompensimi të shpenzimeve për fushatë kanë pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore prej listave të të cilave janë zgjedhur kandidatë për deputetë në shumë prej 15 denarë për votë të fituar;
5. **Fushatë e përforcuar në internet që nuk mund të kontrollohet** – Partitë politike kanë udhëhequr fushatën zgjedhore në mënyrë intensive në mediet elektronike, internet portalet, mediet sociale dhe Google AdWords. Gjithsej 6 parti politike (Koalicioni LSDM, Koalicioni VMRO-DPMNE, BDI, Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi, E majta dhe Besa) kanë udhëhequr fushatë në internet portalet që kanë

dorëzuar listën e çmimeve në KShZ. Gjithashtu, në këto zgjedhje ishte vërejtur që mediet sociale në mënyrë aktive përdoren si vegël për informim dhe reklamim të partive politike, si dhe të personave që kanë qenë kandidatë për deputetë. Në bazë të zbulimeve nga monitorimi, këto shpenzime nuk janë ndjekur madje as nga institucionet dhe këto informacione nuk kanë qenë të gatshme në raportet zyrtare të pjesëmarrësve në këto fushata zgjedhore.

Në pasqyrën grafike 1 janë prezantuar shpenzimet e vlerësuara nga monitorimi në krahasim me shpenzimet e publikuara nga partitë politike.

Pasqyra grafike 1

Krahasimi i shpenzimeve të publikuar dhe vlerësuar në fushatën zgjedhore (MKD)




1. Kategorizimi i shpenzimeve të partive politike

Analiza e shpenzimeve të vlerësuara për fushatën zgjedhore është kryer në bazë të tre kategorive të përcaktuar:

- Shpenzime në nivelin kombëtar
- Shpenzime në nivelin lokal
- Shpenzime në pjesën kreative dhe provizione për agjenci

Sipas vlerësimeve të TI-M, të gjitha partitë politike dhe koalicionet që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në dhjetor 2016 kanë shpenzuar gjithsej 326.021.493 MKD për fushatën zgjedhore prej të cilëve në nivelin kombëtar janë 279.840.012 MKD ndërsa në nivelin lokal janë 46.181.481 MKD.

Pasqyrë grafike 2



Shpenzime në nivelin kombëtar


Në nivelin kombëtar janë monitoruar: përfaqësimet mediatike në televizione kombëtare (gjithsej 11 televizione); reklamim të jashtëm (gjithsej 4 operatorë më të mëdha të jashtëm); medie të shtypura (gjithsej 8); internet portale (gjithsej 49). Për monitorimin ishin angazhuar agjenci të jashtëm për televizionet kombëtare Nielsen - Audio Measurement dhe medie të shtypit- Press Clipping.

Gjatë procesit të monitorimit të shpenzimeve në nivelin kombëtar gjithashtu ishin përfshirë edhe shpenzimet për materiale promovimi dhe shpenzime për mitingje të organizuara.

Për shkak të vëllimit të operatorëve (gjithsej 4), prezantimi mediatik i radio stacioneve kombëtare nuk është përfshirë në ndjekjen e shpenzimeve.

Shuma totale e shpenzimeve të vlerësuara të të gjitha partive politike në nivel kombëtarë janë 85,8%.

Pasqyrë grafike 3




Shpenzime në nivel lokal

Në nivel lokal janë monitoruar shpenzimet për takime me qytetarët, të mbajtura në nivel lokal nga ana e partive politike, qiraja e zyrave si dhe përfaqësimi në mediet në nivel lokal (janë monitoruar: 50 televizione lokale dhe 3 medie lokale të shtypura).

Për shkak të vëllimit të operatorëve (gjithsej 42), përfaqësimi mediatik i radio stacioneve lokale nuk është përfshirë në monitorimin e shpenzimeve.

Nga shuma e përgjithshme e shpenzimeve, partitë politike në nivel lokal kanë shpenzuar 14,2%.

Pasqyrë grafike 4




Shpenzimet për pjesën kreative dhe provizionet e agjencive

Pjesa kreative (përpilim i videove, post produksion, audio produksion, zgjedhje grafike artistike, përgatitje për shtypje, përgatitje të banderolave) si dhe provizioni i agjencive për planifikim mediatik dhe blerja e hapësirës mediatike, u vlerësua si shpenzim prej 7% të shumës së përgjithshme të fushatës mediatike.

2. Vlerësim i shpenzimeve për përfaqësim mediatic

Sipas vlerësimit, pjesa më e madhe e mjeteve në fushatën zgjedhore janë shpenzuar për përfaqësim mediatic të partive politike në televizionet kombëtare, pas cilës vijnë: materiale promovuese propaganduese, shpenzime për organizimin dhe mbajtjen e mitingjeve, si dhe shpenzimet e paraqitura më poshtë në grafikun.

Pasqyrë grafike 5:



3. Vlerësimi i shpenzimeve të partive politike në fushatën zgjedhore

Janë zhvilluar analiza për aktivitetet për të cilat mundeshe të përcaktohet çmimet në treg, ose të fitohen relativisht vlerësime të mira për shpenzimet e bëra. Qasja jonë bazohet në vlerësim, që merr parasysh çmimet e tregut. Kjo pozitë është përfundimisht e arsyetuar pasi që mendojmë se kompanitë, mediat dhe pjesëmarrësit tjerë në fushatat zgjedhore që do kishin përjetuar vetëm duke punuar sipas logjikës së tregut.

Janë analizuar aktivitete në nivel kombëtar dhe lokal.

A) Në nivel kombëtar janë monitoruar:

- TV fushatat në televizionet kombëtare.
- Furnizimi dhe përpilimi i materialeve propaganduese
- Organizimi i ngjarjeve
- Fushata në mediat e shtypura
- Reklamimi i jashtëm dhe
- On-line fushata në portalet kombëtare.

1. Për monitorimin e fushatave televizive është angazhuar agjenci profesioniste.

2. Për kategorinë *Furnizim dhe përpilim të materialeve propaganduese*, sipas madhësisë së trupit zgjedhor në nivel të tërë vendit është kryer vlerësim i materialit të përgatitur propagandues ku përfshihen të gjitha programet e shtypura, materialet propaganduese (fletushka, gota, kapele, shalle, çanta) deh çmimi mesatar furnizues për ato.

3. Çmimi i shpenzimeve të mitingjeve të mëdha dhe të vogla është nxjerr nga madhësia e vëzhguar dhe kohëzgjatjen e tyre sipas çmimeve të tregut për marrje me qira të hapësirës, pajisjes dhe burimeve njerëzore.

4. Mjetet e vlerësuara në fushatat në mediat e shtypura janë në përputhje me madhësitë e vëzhguara të hapësirës së shfrytëzuar dhe çmimet e tregut për ato.

5. Sa i përket reklamimit të jashtëm që ka të bëjë me hapësirat për bilbordet dhe ngjashëm është kryer vlerësimi në bazë të sipërfaqeve të vëzhguara në mbarë vendin dhe çmimet e tregut për ato.

6. On-line fushata është e ndjekur vetëm në portalet maqedonase dhe janë marr parasysh numrat e shpalljeve mesatare dhe çmimet e tyre të tregut.

Në këto vlerësime nuk janë marr parasysh reklamat në radio stacionet, pasi që këto nuk janë matur.

Gjithashtu është marr parasysh edhe fushata në rrjetet sociale.

B) Në nivel lokal janë matur (monitoruar) aktivitetet e partive dhe koalicioneve në 24 qytete dhe vendbanime në mbarë vendin.

Në qytetet dhe vendbanimet e zgjedhura janë vëzhguar

1. Numri i zyrave, madhësia e tyre dhe çmimi i qirasë.
2. Numri i takimeve me qytetarët, pulset dhe tribunat si dhe sa të vizituar kanë qenë
3. Fushatat televizive në televizionet lokale


Duke marr parasysh numrin e votuesve të regjistruar sipas komunave, përqindjen e votimit të votuesve në zgjedhjet e mbajtura si dhe sipërfaqen që e përfshin secila komunë, janë zhvilluar vlerësimet për shpenzimet në nivel lokal.

Për të gjitha shpenzimet e vlerësuara, përveç qiramarrjes së zyrave dhe jetëve për takime me qytetarë janë llogaritur 7% për shërbime të Agjencive dhe 18% TVSH.

Në shpenzimet e vlerësuara nuk është marr parasysh mundi intelektual i investuar në dizajnin e fushatave, përgatitjet e videove dhe paneleve me reklame.

Koalicioni VMRO DPMNE

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktivitetet promovuese në fushatën zgjedhore Koalicioni VMRO–DPMNE ka shpenzuar 126.235.357 denarë, prej të cilëve 15.399.748 denarë në nivel lokal dhe 110.835.609 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Koalicioni VMRO për Maqedoninë ka shpallur shpenzime në lartësi prej 117.212.742 denarë.

Koalicioni në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 454.577 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 278 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 258 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	126.235.357	117.212.742
Vota të fituara	454.577	454.577
Çmime për votë	278	258

Koalicioni LSDM

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktivitetet promovuese në fushatën zgjedhore Koalicioni LSDM ka shpenzuar 111.102.468 denarë, prej të cilëve 15.400.748 denarë në nivel lokal dhe 95.701.720 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Koalicioni LSDM ka shpallur shpenzime në lartësi prej 33.923.911 denarë.

Koalicioni në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 436.981 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 254 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 78 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	111.102.468	33.923.911
Vota të fituara	436.981	436.981
Çmime për votë	254	78

Bashkimi demokratik për integrim (BDI)

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktiviteteve promovuese në fushatën zgjedhore Bashkimi demokratik për integrim ka shpenzuar 45.777.718 denarë, prej të cilëve 3.129.685 denarë në nivel lokal dhe 42.648.033 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Bashkimi demokratik për integrim shpalli shpenzime në lartësi prej 22.684.550 denarë.

Partia në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 86.796 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 527 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 261 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	45.777.718	22.684.550
Vota të fituara	86.796	86.796
Çmime për votë	527	261

Partia demokratike e shqiptarëve (PDSH)

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktiviteteve promovuese në fushatën zgjedhore Partia demokratike e shqiptarëve ka shpenzuar 7.646.395 denarë, prej të cilëve 2.056.205 denarë në nivel lokal dhe 5.590.189 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Partia demokratike e shqiptarëve shpalli shpenzime në lartësi prej 2.044.210 denarë.

Partia në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 30.964 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 247 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 66 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	7.646.395	2.044.210
Vota të fituara	30.964	30.964
Çmime për votë	247	66

Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi – Blloku i tret

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktivitetet promovuese në fushatën zgjedhore Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi ka shpenzuar 5.026.447 denarë prej të cilëve 2.763.119 denarë në nivel lokal dhe 2.263.328 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi shpalli shpenzime në lartësi prej 2.469.485 denarë.

Partia në zgjedhjet Parlamentare 2016 fitoi gjithsej 10.028 vota. Sipas shpenzimeve të vlerësuara, për një votë janë harxhuar 501 denarë, kurse sipas raportit financiar një votë kushton 246 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	5.026.447	2.469.485
Vota të fituara	10.028	10.028
Çmime për votë	501	246

Partia për prosperitet demokratik (PPD)

Pasqyrë grafike e shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktivitete promovuese në fushatën zgjedhore Partia për prosperitet demokratik ka shpenzuar 437.685 denarë, prej të cilëve 110.040 denarë në nivel lokal dhe 327.645 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Partia për prosperitet demokratik shpalli shpenzime në lartësi prej 262.761 denarë.

Partia në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 1.143 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 383 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 230 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	437.685	262.761
Vota të fituara	1.143	1.143
Çmime për votë	383	230

Koalicioni – Aleanca e shqiptarëve

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktiviteteve promovuese në fushatën zgjedhore Koalicioni – Aleanca e shqiptarëve ka shpenzuar 5.579.982 denarë , prej të cilëve 1.278.763 denarë në nivel lokal dhe 4.301.219 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Koalicioni - Aleanca e shqiptarëve shpalli shpenzime në lartësi prej 1.052.030 denarë.

Koalicioni në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 35.121 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 159 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 30 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	5.579.982	1.052.030
Vota të fituara	35.121	35.121
Çmime për votë	159	30

Partia liberale e Maqedonisë (LP)

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktiviteteve promovuese në fushatën zgjedhore Partia liberale e Republikës së Maqedonisë ka shpenzuar 2.702.664 denarë , prej të cilëve 1.296.613 denarë në nivel lokal dhe 1.406.050 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Partia liberale e Republikës së Maqedonisë ka shpallur shpenzime në lartësi prej 478.456 denarë.

Partia në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 3.840 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 704 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 125 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	2.702.664	478.456
Vota të fituara	3.840	3.840
Çmime për votë	704	125

Koalicioni VMRO për Maqedoninë

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktivitetet promovuese në fushatën zgjedhore Koalicioni – Aleanca e shqiptarëve ka shpenzuar 7.874.169 denarë, prej të cilëve 2.783.754 denarë në nivel lokal dhe 5.090.416 denarë në nivel kombëtar.

Në raportet financiare Koalicioni VMRO për Maqedoninë ka shpallur shpenzime në lartësi prej 8.364.675 denarë.

Koalicioni në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej gjithsej 24.524 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 321 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 341 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	7.874.169	8.364.675
Vota të fituara	24.524	24.524
Çmime për votë	321	341

Lëvizja BESA

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktivitetet promovuese në fushatën zgjedhore Lëvizja BESA ka shpenzuar 12.971.206 denarë, prej të cilëve 1.663.820 denarë në nivel lokal dhe 11.307.386 denarë në nivel kombëtar.


Në raportet financiare Lëvizja BESA ka shpallur shpenzime në lartësi prej 8.725.348 denarë.

Partia në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 57.868 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 224 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 151 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	12.971.206	8.725.348
Vota të fituara	57.868	57.868
Çmime për votë	224	151

E majta

Pasqyrë grafike e vlerësimit të shpenzimeve (MKD)



Sipas vlerësimit të shpenzimeve për aktiviteteve promovuese në fushatën zgjedhore partia E majta ka shpenzuar 667.403 denarë , prej të cilëve 299.986 denarë në nivel lokal dhe 367.417 denarë në nivel kombëtar.

Në raportet financiare partia E majta ka shpallur shpenzime në lartësi prej 122.570 denarë.

Partia E majta në Zgjedhjet parlamentare 2016 fitoi gjithsej 12.120 vota. Sipas vlerësimit të shpenzimeve për një votë janë shpenzuar 55 denarë, kurse sipas raportit financiar të shpallur një votë ka kushtuar 10 denarë.

	Shpenzime të vlerësuara	Shpenzime të shpallura
Gjithsej denarë	667.403	122.570
Vota të fituara	12.120	12.120
Çmime për votë	55	10

4. Rekomandime

- Organet kompetente shtetërore (EShR, DAP) të kryejnë kontrole të plotë të kontabilitetit dhe punës tjetër financiare të subjekteve politike që kanë marr pjesë në procesin zgjedhor;
- Raportet nga këto kontrole të jenë publike;
- Themelimi i sistemit me përcaktim të institucionit kompetent që do të ndjek mediet elektronike. (Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do të ndjek mediet elektronike (internet portalet) gjatë fushatave zgjedhore sipas dispozitave të parapara në Kodin zgjedhor);
- Të themelohet detyrim për paraqitjen e shpenzimeve të internet portaleve. Paraqitja zgjedhore mediatike e partive politike në mediet elektronike – internet portalet (Facebook, Google adverts, YouTube) është një zonë e parregulluar, dhe për shkak të kësaj duhet doemos të përpilohet zgjedhje normative me të cilën do të ndiqen shpalljet e reklamave në internet portalet;
- Plotësim i rregullave për dhënien me qira të paneleve dhe bilbordeve me reklama. Të themelohet mënyrë transparente për dhënien me qira të bilborde dhe paneleve për reklama ose lokacioneve të nxjerra, pasi partitë tjerra politike kanë të drejtë ti marrin ato me qira siç është rregulluar me Kodin zgjedhor (neni 78-a, paragrafi 7);
- Përforcimi i mekanizmave për sanksionim të subjekteve politike tek të cilët do të përcaktohen parregullsitë në raportet financiare të dorëzuara gjatë fushatave zgjedhore, nga lloji i ndalesës për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme që mund të shqiptohet nga ana e KShZ ose EShR sipas kompetencave të tyre.

II. MONITORIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE NË PERIUDHËN PARAZGJEDHJEVE DHE PERIUDHËN E ZGJEDHJEVE

Monitorimi i shpenzimeve nga buxheti në nivel qendror dhe lokal paraqet proces të ndërlikuar që fillimisht kërkon përcaktimin e metodologjisë dhe më vonë dizajnin e skemës për zbatim të saj, prej të cilës saktë dhe kohëshëm do të prodhohen informata dhe të dhëna konkrete.

Me qëllim që të realizon këtë operacion, QAE nisi me realizimin e disa aktiviteteve që më tutje do të shërbejnë si bazë për raportet që prodhohen. Gjatë muajit nëntor-dhjetor 2015, ekipi ekspert i Qendrës për analiza ekonomike (QAE) zhvilloi metodologjinë për monitorim të shpenzimeve nga buxheti në nivel qendror dhe lokal në Republikën e Maqedonisë (RM), në periudhën para zgjedhjeve dhe periudhën gjatë zgjedhjeve të parakohshme (në këtë periudhë të paralajmëruara për qershor të vitit 2016, edhe pse momentalisht nuk është përcaktuar data konkrete kur do ishin mbajtur). Zhvillimi i metodologjisë së tillë ka interes të posaçëm për RM duke pasur parasysh se aktivitetet i tillë deri tani nuk është zhvilluar në vend dhe se do të fitohen informata mbi atë nëse dhe sa i shprehur është cikli politik në ciklin ekonomik (lëvizjet fiskale) tek ne.

Metodologjia përbëhet prej dy pjesëve:

1. Monitorimi i shpenzimeve të buxhetit në nivel qendror (zbatim i buxhetit dhe monitorim i shpalljeve të përdoruesve buxhetor).
2. Monitorimi i shpenzimeve buxhetore në nivel lokal (monitorim i zbatimit tremujor të buxheteve komunale dhe monitorim i buxheteve kapitale/shpenzimeve operative),
 - monitorimi në nivel lokal ka edhe komponentin e ndjekjes së shpenzimeve në nivel lokal të njësive të vetëqeverisjes lokale, njësive buxhetore dhe ndërmarrjeve komunale nga ana e vëzhguesve lokal të trajnuar.

Metodologjia do të ndjek shpenzimet dhe paralajmërimet për shpenzime të Qeverisë, përdoruesve buxhetor, përfaqësuesve të tyre, vetëqeverisjes lokale (mostër e përzgjedhur), ndërmarrjeve komunale (mostër e përzgjedhur) dhe përfaqësuesve të tyre dhe do të zbatohet nga ana e Transparenci Interneshënëll – Maqedoni, QAE dhe nga partner organizatat – vëzhgues lokal.

Për realizimin e metodologjisë së zhvilluar që zbatohet për monitorim në këtë raport u krijuan disa vegla (Google forms, excel vegla, baza të dhënave), pyetësor dhe formularë të cilët vëzhguesve lokal, QAE-së dhe TI-M-it, do t'ju mundësojnë platformë për ndjekjen e shpenzimeve publike në periudhën që vijon.

Për zbatimin e kësaj metodologjie, së bashku me organizatën partnere TI-M, u zhvillua një thirrje për vëzhgues lokal të shpenzimeve të buxhetit në nivel lokal, dhe me anë të intervistave të kandidatëve që kanë hyrë në rrethin më të ngushtë, është kryer përzgjedhja e vëzhguesve lokal (gjithsej 8 të përzgjedhur, shih Aneks).

Për koordinim më të lehtë dhe zbatim të metodologjisë për monitorim është përpiluar edhe udhëheqësi i cili ka për qëllim t'ju ndihmon vëzhguesve lokal të përdorin veglat e përpiluara për nevojat e projektit. Para nisjes me monitorimin e shpenzimeve të buxheteve në nivel lokal, u zhvillua një trajnim njëditor (22.12.2015) nga ana e QAE dhe një trajnim njëditor nga ana e TI-M (23.12.2015) ku u prezantuan veglat të cilat do të përdoren nga vëzhguesit gjatë mbledhjes së informatave prej tereni, si dhe mënyrat e raportimit.

1. Monitorim i shpenzimeve buxhetore në nivel qendror

Monitorimi i shpenzimeve buxhetore në nivel qendror; monitorim dhe analizë e raporteve mujore që i publikon Ministria për financa e RM për zbatim të buxhetit

Monitorimi zhvillohet sipas bazës së krijuar të dhënave (nga të dhënat prej raporteve mujore/tremujore të Zbatimit të Buxhetit 2008-2016) nëpërmjet cilave përcaktohen trendët kryesore dhe efektet sezonale në ciklet politike dhe ekonomike dhe ndryshimet në shpenzimet buxhetore në periudhën aktuale, dhe krahasimi i tyre me periudhat e kaluara. Qëllimi i hulumtimi të lëvizjes në pozita të posaçme të të ardhurave/shpenzimeve në buxhetin në periudhën e mëparshme (ciklet e mëparshme zgjedhore) paraqet bazë për të parë skemën sipas cilës ndryshohen rriten/zvogëlohen pozita të caktuara buxhetore para dhe gjatë zgjedhjeve. Kjo më tutje do të na mundëson krahasim të tyre me lëvizjet aktuale të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore dhe me dozë të caktuar të kujdesit dhe parashikimin e mundshëm të lëvizjes së tyre në procesin zgjedhor të ardhshëm.

Monitorim i treguesve për ndjekje të shpenzimeve buxhetore në nivel qendror

Analiza në nivel kombëtar është e bazuar në të dhënat zyrtare në dispozicion për pikat buxhetore nga raportet mujore për zbatim të buxhetit. Qëllimi ynë në periudhën e monitorimit është të ndjekim lëvizjen e pikave të përcaktuara që zakonisht lidhen me ciklin politik dhe ekonomik.

Për çdo të ardhur dhe shpenzim në buxhet që janë pjesë të monitorimit është krijuar bazë e të dhënave në të cilën ndiqet:

- Realizimi i buxhetit, në përqindje në baza mujore dhe tremujore.
- Realizimi grumbullues i buxhetit, në përqindje në baza mujore dhe tremujore.
- Zbatimi absolut i buxhetit në baza mujore dhe tremujore
- Barabarësi në zbatimin e buxhetit në nivel mujor dhe tremujor me qëllim që të shihen devijimet nga mesatarja mujore/tremujore
- Largimi i efektit sezonal të lëvizjes së pikave buxhetore (të ardhura dhe shpenzime) dhe paraqitja e buxhetit me linjë të posaçme në pasqyrat grafike (“faktori sezonal” tek pasqyrat tremujore dhe “faktorët mujor” tek pasqyrat mujore të të dhënave) me qëllim që më qartë të shihen lëvizjet e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara që

eventualisht vijnë nga vendimet diskrecionale, dhe jo nga efektet sezonale. Për secilën nga pikat e posaçme të buxhetit është llogaritur dhe monitoruar edhe trendi që e ndjek.

Pozitat buxhetore që janë pjesë e monitorimit në këtë pjesë të raportit përfshijnë:

- Të ardhurat publike: tatimet e përgjithshme, TVSH, tatimi për fitime, taksat administrative dhe gjobat, tatimi personal i të ardhurave.
- Shpenzimet publike: Shpenzimet kapitale, rrogat dhe kompensimet, mallra dhe shërbime, mbrojtja shëndetësore, shpenzimet për pensionet, kompensimet financiare për të papunësuarit dhe kategoria e transfere tjera që përfshin edhe transferet ndaj NjVQ, subvencionet për bujqësinë.
- Financimi i deficitit: lëvizja e deficitit/suficitit, bonot e thesarit dhe kreditë e huaja

Në analizën që do të vijon do të prezantohen konkluzionet e përgjithshme dhe vetëm pasqyra grafike të përzgjedhura që vërtetojnë konstatimet tona, duke marr parasysh vëllimin e bazës së të dhënave dhe informatave, që e bën të pamundur në tërësi të paraqiten në hapësirë të kufizuar në këtë raport.

Zbulimet kyçe

Monitorim i treguesve për ndjekje të shpenzimeve buxhetore në nivel qendror

- ✓ Para secilit cikël zgjedhor (veçanërisht 2009, 2013 dhe 2014) janë mbledhur shuma më të mëdha të mjeteve nëpërmjet lëshimit të **bonove të thesarit** krahasuar me nivelin e pritur të realizimit të balancuar. Në vitin kishte rritje të dukshme në lëshimin e bonove të thesarit mbi lëvizjet e tyre sezonale/të zakonshme krahasuar me vitet e kaluara edhe atë në tre tremujorët e parë të vitit, kurse në tremujorin e dytë kishte rënie. Në vitin 2016, deri në muajin nëntor, realizimi grumbullues i pikës buxhetore bono thesari ka qenë 112% nga gjithsej buxheti i planifikuar vjetor (gati se 20 p.p. më shumë krahasuar me realizimin e balancuar të pritur në nivel mujor prej 92%) – trendi i rritjes së kësaj pike veçanërisht vërehet në dy muajt e fundit para zgjedhjeve (tetor dhe nëntor).
- ✓ Shënojmë rritje të **kredive të huaja** krahasuar me realizim e balancuar të pritur në periudhat/vitet kur kemi zgjedhje edhe atë në çdo vit zgjedhor 2009, 2011, 2013, 2014, 2016 kurse në vitet kur nuk kemi zgjedhje, shuma e tyre është dukshëm më e ulët. Në pritje të zgjedhjeve në vitin 2016, nga të dhënat shihet dinamika e përforcuar e marrjes së kredive të huaja në tremujorin e tretë dhe katërt të vitit 2015, si dhe dinamika e përforcuar e marrjes së kredive në korrik të vitit 2016 (kur është lëshuar Euroboni i fundit prej 450 milionë denarë, me shkallë interesi prej 5,6% dhe me afat prej 7 vjet).

Deri në muajin nëntor realizimi grumbullues i pikës kredi të huaja ka qenë në vlerë prej 96% nga gjithsej buxheti vjetor i planifikuar, që është për 4 p.p. realizim më i madh nga 92% i balancuar.

- ✓ Lëvizja e **deficiteve** në ciklet e mëparshme zgjedhore konfirmon teorinë e biznes rretheve politike dhe rritja e deficiteve dhe kredive para zgjedhjeve, kurse pas zgjedhjeve pason konsolidim i butë. Nga të dhënat shihet se shpenzimet e buxhetit dhe deficitet pasuese buxhetore rriten dukshëm para zgjedhjeve krahasuar me realizimin e balancuar dhe lëvizjen e tyre të zakonshme sezonale. Në vitin 2015 shohim se pjesë e rëndësishme e deficiteve buxhetore janë realizuar/kryer në tremujorin e parë dhe tremujorin e dytë të vitit. Në vitin 2016 ka devijim nga ky trend dhe dinamika e realizimit grumbullues të deficitit buxhetor deri në muajin nëntor të vitit 2016 ka qenë 59%, që paraqet gati se 33 p.p. realizim më të vogël nga realizimi i pritur i balancuar (92%).
- ✓ **Shpenzimet kapitale** dukshëm janë rritur para dhe gjatë zhvillimit të secilit cikël zgjedhor krahasuar me lëvizjen tyre sezonale/të zakonshme, kurse pas kësaj janë stabilizuar dhe ka pasur rënie e vogël. Në vitin 2015 nëpërmjet ndjekjen së bilancit në kryerjen e shpenzimeve kapitale dhe lëvizjeve të tyre mujore dhe tremujore shihet se ato janë rritur dukshëm krahasuar me lëvizjen e tyre sezonale/të zakonshme, duke nisur nga tremujori i tretë i vitit 2015. Megjithatë në vitin 2016 (deri në muajin nëntor) gjendja është e kundërte dhe realizimi i shpenzimeve kapitale ka një vlerë modeste prej 62%, që është gati se 30 p.p. realizim më i ulët nga realizimi i pritur i balancuar mujor që ka vlerë prej 92%.
- ✓ Shpenzimet për **ndihmë sociale** dukshëm është rritur para dhe gjatë kohës së zgjedhjeve në vitet 2014, 2013 dhe 2011, por jo edhe në 2016, në krahasim me lëvizjen e tyre të zakonshme/periodike. Të dhënat për vitin 2015 tregojnë rritje të shpenzimeve për ndihmë sociale në muajin maj dhe në muajin shtator. Analiza për vitin 2016 tregon se këto shpenzime kanë lëvizje ciklike, gjegjësisht shkalla grumbulluese e realizimit të shpenzimeve për ndihmë sociale deri në muajin nëntor ka qenë 89%, dhe është gati se 3 p.p. nën realizimin e paraparë mujor (grumbullues) prej 92%.
- ✓ Rritje e dukshme e paragrafit “**transferime tjera**” (në të cilën janë përfshirë dotacionet për komunat dhe **subvencionet për fermerët**) menjëherë para çdo procesi zgjedhor prej viteve 2008-2014 në krahasim me realizimin e pritur të barabartë dhe lëvizja e tyre e zakonshme periodike. Në vitin 2016 përqindja përmbledhëse mujore e realizimit të paragrafit – transferime deri në muajin nëntor është 90%, gjegjësisht për 1 p. p. më të ultë nga realizimi i barabartë prej 91%. Shkalla e realizimit arrin kulmin e saj me vlerë prej 13 % në muajin shkurt.
- ✓ Shpenzimet për **rroga dhe kompensime** janë rritur krahasuar me lëvizjen e tyre të zakonshme/sezonale vetëm para zgjedhjeve në vitin 2009 dhe vitin 2014. Kur analizohen

të dhënat interesante është të theksohet konstatimi se kërcimi i shpenzimeve për rroga dhe kompensime (veçanërisht në tremujorin e 3-të të vitit 2015) është më i madhi në të gjithë periudhën e monitoruar duke nisur prej vitit 2008, edhe pse trendi i rritjes së tyre nis ka mesi i vitit 2013. Në vitin 2016, deri në muajin nëntor shkalla grumbulluese e realizimit të shpenzimeve për rroga dhe kompensime është në nivel të lëvizjes së zakonshme sezonale dhe ka vlerën e përafërt prej 90%, gjegjësisht për 2 p.p. më të ulët nga realizimi grumbullues i balancuar deri në muajin nëntor.


- ✓ Shpenzimet për **mallra dhe shërbime** dukshëm janë rritur para secilit cikël zgjedhor krahasuar me lëvizjen e tyre të zakonshme/sezonale. Nga lëvizja tremujore e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2015 shihet se duke nisur nga tremujori i tretë këto shpenzime tregojnë rritje të madhe mbi lëvizjeve të tyre të zakonshme/sezonale. Kjo nuk ndodh në vitin 2016 dhe shkalla grumbulluese mujore e realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime deri në muajin nëntor është një vlerë modeste prej 67%, dhe është për gati se 25 p.p. nën realizimin e balancuar mujor prej 92%.
- ✓ **Transferimet ndaj Agjencisë për punësim** nëpër të cilës realizohen programe dhe politika të shumta mbi punësimin (pjesë e caktuar e kompensimeve në të holla për të papunësuarit dhe shpenzimet për masat aktive për punësim) rriten duke nisur nga tremujori i dytë i vitit 2015, kur kemi rritje të shpenzimeve për atë. Në vitin 2016 shkalla grumbulluese mujore e realizimit të transferimeve sociale ndaj Agjencisë për punësim deri në muajin nëntor ka qenë në vlerë modeste prej 77%, dhe gati se 15 p.p. nën realizimin e paraparë të balancuar mujor. Sa i përket lëvizjes së transferimeve/shpenzimeve për Agjencinë për punësim, nëse i ndjekim këto në vitet e cikleve zgjedhore të mëparshme, vërehet rritja e tyre e dukshme) krahasuar me lëvizjen e tyre të zakonshme/sezonale para dhe gjatë procesit zgjedhor në vitet 2014, 2011 dhe vitin 2009.
- ✓ Realizimi i të ardhurave nga taksa administrative dhe gjoba në vitin 2015 duke filluar nga tremujori i 2 dhe 3 zvogëlohet, gjegjësisht kemi një rënie të madhe të realizimit të tyre në krahasim me atë që pritej. Në vitin 2016 realizimi përmbledhës i të ardhurave nga taksat administrative dhe gjoba deri në muajin nëntor ka qenë 70%, që paraqet për 22 p. p. realizim më të ultë nëse do të realizohej buxheti në mënyrë të barabartë për këtë paragraf çdo muaj gjatë gjithë vitit. Lëvizje të tilla janë vërejtur edhe në vitet 2014 dhe 2013 kur kemi trend të zvogëlimit të taksave dhe gjobave administrative dhe devijim në rënie nga lëvizjet e tyre të zakonshme.
- ✓ **Të ardhurat tatimore** para çdo cikli zgjedhor kanë qenë më të ultë dhe realizimi/pagesa e tyre ka qenë më ultë para zgjedhjeve (pas zgjedhjeve kemi përqindje më të lartë të realizimit të të ardhurave tatimore) në krahasim me lëvizjen e tyre të

zakonshme/periodike. Në vitin 2015 vërejmë rritje të të ardhurave tatimore prej në muajin gusht deri në muajin tetor, sipas të dhënave të adaptuara sezonale, kurse niveli i realizimit zë të ardhurave tatimore në tremujorin e katërt është dukshëm më i lartë. Në vitin 2016 totali i tatimeve deri në muajin nëntor kryesisht ndjek dinamikën e zakonshme mujore dhe realizimi i tyre grumbullues është i përafërt me 92% e balancuar.

- ✓ Nga realizimi i të ardhurave prej **TVSH-së** (në ciklet zgjedhore në vitet 2014, 2013, 2011, 2009 dhe 2008) shihet se përqindja e realizimit krahasuar me realizimin e paraparë të balancuar është dukshëm më e madhe pak para zgjedhjeve dhe se efekti zgjat në dy tremujorët e ardhshëm (ndryshon prej zgjedhje në zgjedhje). Në vitin 2015 shohim se cikli pozitiv ekonomik/politik ka nisur pak më herët dhe të ardhurat nga TVSH-ja nisin të rriten duke nisur nga tremujori i dytë, që është rezultat i aktivitetit ekonomik të përshpejtuar (në këtë lëvizje të të ardhurave të TVSH-së merr pjesë edhe kthimi i TVSH-së që kryhet, për të cilin nuk kemi të dhëna konkrete mbi shumat dhe kohën kur realizohet). Në vitin 2016 shkalla grumbulluese e realizimit të TVSH-së pas rënies së butë në muajin shkurt kthehet në lëvizjen e saj të pritur sezonale dhe është përafërsisht (91%) sa edhe realizimi grumbullues i balancuar deri në muajin nëntor prej 92%.

Shpalljet publike në ueb faqet e Qeverisë dhe përdoruesve të zgjedhur buxhetor

- ✓ Intensiteti i publikimeve në periudhën e fundit të monitorimit (qershor-dhjetor 2016) është rritur dukshëm, e pazakonshme për periudhën paraprake pak para zgjedhjeve të planifikuara.
- ✓ Mund të vërehet se përkaj numrit të vogël të shpalljeve tek përdoruesit buxhetor dhe përmbajtja e shpalljeve që është me të dhëna modeste cilësore dhe sasiore – gjegjësisht tek të gjitha institucionet e monitoruara (ku ata kanë publikuar çfarëdo lloj shpalljeje) përqindja e informatave të publikuara është shumë e vogël.
- ✓ 21% të publikimeve të plota të Qeverisë së RM-së dhe përdoruesve tjerë buxhetorë (262 publikime) përmbajnë të dhëna financiare për investimet e bëra/planifikuara ose për publikimet në të cilat paralajmërohet investim i ri (Qeveria ka më së shumti publikime).
- ✓ 10% të publikimeve të plota të gjithë përdoruesve buxhetor në monitorim përmbajnë elaborat analitik të aktiviteteve të planifikuar/realizuar.



- ✓ Një pjesë modeste e publikimeve të gjithë përdoruesve buxhetor (rreth 12%) përfshijnë informacione për burimet e mjeteve, si dhe programet/planet/strategjitë në bazë të cilës paralajmërojnë ose realizojnë projektin e publikuar.
- ✓ Përdoruesit buxhetor në ueb faqet e tyre publikojnë informacione të pamjaftueshme për aktivitetet e tyre.
- ✓ 51 shpallje nga gjithsej 821 shpallje të Qeverisë së RM përmban çfarëdo lloj analitike të shpalljeve, kurse përdoruesit e tjerë buxhetorë në shpalljet e veta nuk kanë të dhëna thelbësore për titujt.
- ✓ Numri më i madh i shpalljeve nga të gjitha ueb faqet e monitoruara kanë të bëjnë me vizita, takime dhe konferenca të përfaqësuesve shtetëror që i kanë pasur në periudhën raportuese.
- ✓ Nga shpalljet e të gjitha ueb faqeve të monitoruara shihet se kryesisht në fokus kanë qenë: të rinjtë dhe të papunësuarit, pensionistët (pjesa tjetër, gjegjësisht pjesa më e madhe është paraparë përgjithësisht për qytetarët, me shpallje të përgjithshme për vizita, takime dhe pjesëmarrje në konferenca të përfaqësuesve të Qeverisë).

2. Monitorim i shpenzimeve në nivel të pushtetit lokal

Në monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave për shpenzimet në nivel të pushtetit lokal rol të rëndësishëm luajnë edhe vëzhguesit lokal (shih Aneks), që çdo ditë ndjekin aktivitetet e komunave të monitoruara dhe në baza ditore përcjellin informatat dhe të dhënat sipas metodologjisë së përcaktuar. Vëzhguesit lokal kanë nisur monitorimin e tyre më 01.01.2016.

Në periudhën e monitorimit, nga fillimi deri më 15.12.2016 janë vërejtur gjithsej 473 shpenzime buxhetore kapitale dhe operative në 24 komunat² (55,2% nga gjithsej numri i banorëve të RM) ku zhvillohet monitorimi, sipas të cilave është vepruar me mbledhjen shtesë të informatave/të të dhënave që kanë të bëjnë me ato.

² Sipas vlerësimeve të popullatës së EShR në 30.06.2014 (www.stat.gov.mk) për 22 prej 24 komunat ku është zhvilluar monitorimi është 997.903 banorë, për komunat Qendër dhe Aerodrom evidentohet si Shkup, pjesa tjetër dhe Sopishte dhe numri i banorëve për këto komuna është në bazë të dhënave të ueb faqeve të komunave, gjegjësisht për Qendër 45.362 banorë, dhe Aerodrom 98.382 banorë. Gjithsej këto 24 komuna, që janë lëndë e monitorimit, kanë 1.141.647 banorë, që paraqet 55,2% nga numri i përgjithshëm i banorëve të RM që është 2.067.471 banorë, sipas vlerësimeve të EShR prej 30.06.2014.

Zbulim kyçe

Në këtë periudhë raportuese janë evidentuar të gjitha shpenzimet e shënuara në nivel lokal, prej fillimit të monitorimit të këtij pushteti - 01.01.2016.

- ✓ Prej 01.01.2016-15.12.2016 janë vërejtur gjithsej 473 shpenzime buxhetore kapitale dhe operative në 24 komunitat për të cilat është kërkuar mbledhje plotësuese e informacioneve/të dhënave.
- ✓ Nga gjithsej shpenzimet e evidentuara (473) për 46% gjegjësisht për 218 shpenzime janë dorëzuar KQIKP kurse informatat tjera janë fituar me kontakt të drejtpërdrejt me komunën ose informatat kanë qenë në dispozicion publik në ueb faqe.
- ✓ Nga të dhënat në dispozicion të marra nga grupi lokal i monitorimit, përcaktohet që pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale/operative në nivelin lokal që ishin identifikuar në Ohër, Veles, Strumicë dhe Shtip, ndërsa më pak ishin identifikuar në Kratovë, Vrapçisht dhe Karbinci – që janë vende më të vogla rurale.
- ✓ Sa i prekët ndarjes kryesore të shpenzimeve në operative dhe kapitale (në mënyrë ilustrative të paraqitura në grafikun më poshtë), më shumë se tre të katërtat e shpenzimeve të regjistruara kanë të bëjnë me investimet kapitale.
- ✓ Në kuptim të fushave të investimit si më kryesore mund të dallohen: rinovimi/rindërtimi i çerdheve/shkollave dhe objekte tjera arsimore, rindërtimi i rrugëve dhe rrugicave dhe rindërtim i rrjeteve të kanalizimit dhe ujësjellësit.
- ✓ Nga gjithsej 473 shpenzime të evidentuara në periudhën e monitorimit, 63 kanë të bëjnë me rindërtimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, 181 me rindërtimin e rrugëve dhe rrugicave, 49 me rinovimin/rindërtimin e shkollave, çerdheve, shtëpive sociale dhe tjera, kurse 18- shpenzime janë që nuk mund të vendosen në kategoritë e lartpërmendura.
- ✓ Nga gjithsej 473 shpenzime të evidentuara, për 339 prej tyre ka të dhëna të pjesshme ose të plota.
- ✓ 9% të shpenzimeve të evidentuar për të cilët ka së paku të dhëna minimale janë parashikuar në një strategji të caktuar të komunës përkatëse, 48% të shpenzimeve janë parashikuar në ndonjë prej programeve të komunës, 44% janë parashikuar në programin përkatës buxhetor, 34% të shpenzimeve janë parashikuar/bërë me vendim të këshillit ndërsa 28% janë parashikuar me plan.

- ✓ 1% prej shpenzimeve janë paraparë/përmbajtur në të gjitha 5 dokumentet gjegjësisht në strategjinë, programin, programin buxhetor, vendimin e këshillit dhe planin. 10% të shpenzimeve gjenden në 4 dokumente, 32% janë të parapara/gjenden në 3 dokumente, 14% në 2 dokumente dhe 19% vetëm në një dokument. Për 32% të shpenzimeve nuk ka të dhëna të qarta dhe të plota.

- ✓ Për 39% nga kërkesat e dorëzuara (KQIKP) është pranuar përgjigje në suaza të afatit ligjore, për 26% prej kërkesave ende pritet përgjigje (gjegjësisht ende nuk ka kaluar afati për përgjigje) kurse për 34% nga kërkesat e dorëzuara për qasje ndaj informatave me karakter publik nuk është pranuar përgjigje në suaza të afatit ligjor